

---

**L I G J**  
**PËR MEDIA**

**Lënda**

**Neni 1**

Me këtë ligj përcaktohen parimet dhe kushtet themelore që duhet të përmbushen nga emetuesit e mediave të përcaktuara me këtë ligj gjatë kryerjes së veprimtarisë.

**Përkufizime**

**Neni 2**

Shprehje të caktuara, në kuptim të këtij ligji, e kanë kuptimin si vijojnë:

1. Mediat janë mjete për informim publik, përkatësisht çfarëdo qoftë lloj komunikimi si gazeta, magazina, programe të radios dhe televizionit, publikime elektronike, teletekst dhe mjete tjera për shpallje ditore ose periodike të përmbajtjeve të formuluara redaktuese në formë të shkruar, zë ose fotografi, me qëllim që të informohen dhe të përmbushen nevojat kulturore, arsimore dhe të tjera të

publikut më të gjerë. Mediat nuk janë buletine, katalogë, forma tjera të publikimeve, pavarësisht nga mjeti për publikim, të dedikuara vetëm për shpallje, sistemin arsimor ose për korrespondencë afariste, për punën e shoqërive tregtare, institucioneve, shoqatave, partive politike, organeve shtetërore dhe gjyqësore, ndërmarrjeve publike, personave juridikë me autorizim publik dhe organizatave fetare. Si media nuk konsiderohen edhe gazetatat dhe buletinet e institucioneve arsimore, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", publikimet e njëjësive të vetëqeverisjes lokale, pllakate, broshura, prospekte dhe transparente;

2. Përmbajtjet e mediave (në tekstin e mëtejme: përmbajtje) janë të gjitha llojet e informatave (lajme, mendime, njoftime, raporte dhe informata tjera) si dhe vepra autoriale që publikohen, përkatësisht emetohen përmes mediave;

3. Publikimet elektronike janë versione elektronike të gazetave/magazinave që përmes ueb faqeve të internetit janë të arritshme për publikun më të gjerë, pa marrë parasysh vëllimin e tyre;

4. Emetuesi i mediave është personi fizik ose juridik që kryen veprimtarinë e botimit të medias së shtypur, publikimeve elektronike ose emetimit të programeve të radios dhe televizionit (radiodifuzerë);

5. Gazetar është personi i cili kryen aktivitete të grumbullimit, analizimit, përpunimit, formulimit dhe/ose klasifikimit të informatave që janë publikuar në media dhe është i punësuar tek emetuesi i medias ose ka lidhur marrëveshje me të njëjtin ose është gazetar i cili kryen veprimtari gazetareske si profesion të pavarur (gazetar i lirë) dhe

6. Trup rregullator kompetent është Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

### Liria e të shprehurit dhe liria e mediave

#### Neni 3

(1) Garantohet liria e të shprehurit dhe liria e mediave.

(2) Liria e mediave në veçanti i përfshin: lirinë e të shprehurit të mendimit, pavarësinë e mediave, lirinë e grumbullimit, hulumtimit, publikimit, zgjedhjes dhe transmetimit të informatave në drejtim të informimit të publikut, pluralizmin dhe shumëllojshmërinë e mediave, lirinë e qarkullimit të informatave dhe transparencën e mediave për mendime të ndryshme, bindje dhe për përmbajtje të shumëllojshme, arritshmërinë në informata me karakter publik, respektimin e individualitetit të njeriut, privatësinë dhe dinjitetin, lirinë për themelim të personave juridikë për kryerjen e veprimtarisë për informim publik, botim dhe distribuim të mediave të shtypura dhe mediave tjera nga vendi dhe nga jashtë, prodhimin dhe emetimin e programeve audio/audiovizuale, si edhe mediat tjera elektronike, pavarësinë e redaktorit, gazetarit, autorëve ose kreatorëve të përmbajtjeve ose bashkëpunëtorëve programorë dhe personave tjerë e në pajtim me rregullat e profesionit.

(3) Liria e mediave mund të kufizohet vetëm në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

(4) Emetuesi i medias është i pavarur në politikën redaktuese, përkatësisht në zbatimin e konceptit programor të medias dhe i njëjti është përgjegjës për punën e vet në pajtim me këtë ligj dhe me ligj tjetër.

### Ndalime të veçanta

#### Neni 4

Ndalohet që me publikimin, përkatësisht emetimin e përmbajtjeve në media të cenohet siguria nacionale, të nxitet shkëlja e dhunshme e rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, të bëhet thirrje në agresion ushtarak ose konflikt të armatosur, të nxitet ose përhapet diskriminimi, mosdurimi ose urrejtja në bazë të racës, gjinisë, religjionit ose kombit.

### Kushtet themelore për emetimin e mediave

#### Neni 5

(1) Personi juridik ose fizik mundet në Republikën e Maqedonisë të kryejë veprimtari të emetimit të mediave të shtypura ose të emetimit të publikimit elektronik nëse veprimtarinë e regjistron në Regjistrin tregtar ose në regjistrin e personave tjerë juridikë që i mban Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë dhe ka seli dhe redaksi në Republikën e Maqedonisë.

(2) Personi juridik ose fizik mundet në Republikën e Maqedonisë të kryejë veprimtari të emetimit të programeve të radios ose televizive nëse veprimtarinë e regjistron në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, ka seli dhe redaksi në Republikën e Maqedonisë dhe ka leje për emetim në radio apo televizion.

(3) Veprimtaria e emetimit të programeve të radios ose televizive nga paragrafi (2) i këtij neni, si dhe dhënia e lejes për emetim të radios ose televizionit, më hollësisht rregullohet me Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

(4) Trupi kompetent rregullator mban regjistra të emetuesve të mediave që i publikon në ueb faqen e vet, në pajtim me këtë ligj dhe me Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

(5) Regjistri i emetuesve të medias së shtypur dhe regjistri i emetuesve të publikimeve elektronike përmban të dhëna për:

- firmën dhe selinë, përkatësisht emrin dhe adresën e emetuesit të medias së shtypur përkatësisht emetuesit të publikimeve elektronike,

- emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës të emetuesit të medias së shtypur, përkatësisht të emetuesit të publikimeve elektronike,

- emrin e gazetës, magazinës, përkatësisht emrin e publikimit elektronik dhe

- ueb faqen e publikimit elektronik.

(6) Të dhënat nga paragrafi (5) i këtij neni, trupi rregullator kompetent i merr nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, i cili është i detyruar në afat prej pesë ditëve nga dita e regjistrimit të kryer, të njëjtat t'i dorëzojë falas.

### Obligimi për sigurimin e mbrojtjes së personave të mitur

#### Neni 6

(1) Media e shtypur me përmbajtje pornografike doemos duhet të ketë paralajmërim të dukshëm se përmban pornografi, si dhe paralajmërim se distribuimi përkatësisht shitja e tij ndalohet për persona të mitur dhe të paketohehet në foli të tejdukshme prej najloni.

(2) Emetuesi i publikimit elektronik është i detyruar që me ndihmën e mjeteve teknike ose me mbrojtje përkatëse për kufizim të pamundësorë që personat e mitur të kenë qasje në publikimet elektronike me përmbajtje pornografike.

(3) Mbrojtja e personave të mitur gjatë emetimit të programeve të radios ose televizive sigurohet në mënyrë të përcaktuar në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

### Obligimi për publikimin e informatave të caktuara

#### Neni 7

(1) Emetuesit e mediave janë të detyruar që me kërkesë të organit ose trupit kompetent shtetëror, pa kompensim të publikojnë kumtime, si dhe deklarata zyrtare të organeve ose trupave kompetentë shtetërorë në rast të gjendjes së luftës ose cenimit të drejtpërdrejtë të pavarësisë dhe sovranitetit të Republikës së Maqedonisë, në rast të fatkeqësive të mëdha natyrore, fatkeqësive teknike-

teknologjike dhe ekologjike dhe epidemive kur ekziston rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe sigurinë e vendit.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtrohet në formë të shkruar dhe doemos duhet të përmbajë të dhëna që e dëshmojnë autenticitetin e saj dhe bazën juridike.

### Redaktori përgjegjës

#### Neni 8

(1) Çdo emetues i medias doemos duhet të ketë redaktor përgjegjës, i cili është gazetar dhe e emëron dhe shkarkon emetuesi i medias.

(2) Para emërimit apo shkarkimit të redaktorit përgjegjës, emetuesi i medias është i obliguar që të kërkojë mendim nga redaksia, nëse me aktin nga neni 10 paragrafi (1) të këtij ligji nuk është rregulluar ndryshe. Redaksia obligohet që mendimin ta dorëzojë në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(3) Redaktori përgjegjës e udhëheq realizimin e përmbajtjeve që publikohen, përkatësisht emetohen dhe përgjigjet për çdo informatë të publikuar në media, në pajtim me ligjin.

(4) Nëse emetuesi i medias ka më shumë redaktorë përgjegjës secili prej tyre përgjigjet për përmbajtjen e pjesës përmbajtësore mediatike për të cilën është përgjegjës.

(5) Radiotelevizioni i Maqedonisë për çdo servis programor që e emeton duhet të ketë redaktor përgjegjës.

(6) Si redaktor përgjegjës nuk mund të emërohet personi i cili në suaza të kryerjes së funksionit të vet gëzon imunitet nga përgjegjësia penale.

### Redaksia

#### Neni 9

Redaksia në emetuesin e medias përbëhet prej redaktorit përgjegjës dhe redaktorëve, ndërsa mund të përfshijë edhe bashkëpunëtorë tjerë programorë nëse me aktin nga neni 10 paragrafi (1) të këtij ligji, kjo është e përcaktuar. Nëse emetuesi i medias nuk ka redaktorë, atëherë redaktori përgjegjës vetë e kryen funksionin e redaksisë.

### Akti i emetuesit të medias

#### Neni 10

(1) Emetuesi i medias, i cili është person juridik është i detyruar në afat prej 90 ditësh nga dita e fillimit me punë të miratojë akt të përgjithshëm me të cilin në veçanti do të rregullohet:

- përbërja e redaksisë,
- të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e redaktorit përgjegjës, redaktorëve dhe gazetarëve,
- të drejtat dhe obligimet e ndërsjella ndërmjet emetuesit të medias, redaktorit përgjegjës, redaktorëve dhe gazetarëve,
- mënyra dhe procedura për emërimin dhe shkarkimin e redaktorit përgjegjës dhe
- çështje tjera të lidhura me punën e medias.

(2) Emetuesi i medias është i detyruar që aktin nga paragrafi (1) të këtij neni ta bëjë publikisht të arritshëm.

(3) Emetuesi i medias duhet t'i respektojë rregullat profesionale të profesionit të gazetarit të përcaktuara nga organizata profesionale të gazetarëve.

### E drejta e gazetarit që ta shprehë mendimin dhe qëndrimin e tij dhe të refuzojë të zbatojë urdhër, përkatësisht detyrë

#### Neni 11

(1) Gazetarit nuk mund t'i ndërpritet marrëveshja për punë, t'i zvogëlohet rroga ose t'i ndryshohet pozita në redakturë ose redaksi, përkatësisht t'i zvogëlohet apo ndërpritet pagesa e kompensimit të kontraktuar ose pjesë e tij, si dhe t'i zvogëlohen ose hiqen edhe disa prej të drejtave tjera të përcaktuara në Ligjin për marrëdhënie pune, për shkak të shprehjes së mendimit dhe qëndrimit të vet, nëse janë në pajtim me rregullat profesionale të profesionit të gazetarit nga neni 10 paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Gazetari ka të drejtë të refuzojë të përpilojë, shkruajë ose të marrë pjesë në përpilimin e kronikës përmbajtja e së cilës është kundër rregullave profesionale të profesionit të gazetarit për çka redaktorit përgjegjës i dorëzon deklaratë me shkrim.

(3) Dispozitat nga ky nen nuk e përjashtojnë përgjegjësinë e gazetarëve në raste të përcaktuara në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.

### Mbrojtja e burimit të informatave

#### Neni 12

(1) Gazetari ka të drejtë të mos e zbulojë burimin e informatës, përkatësisht të dhënat që mund ta zbulojnë burimin në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

(2) Të drejtën nga paragrafi (1) i këtij neni e kanë edhe personat tjerë të cilët për shkak të lidhshmërisë së tyre profesionale me gazetarin janë të njoftuar me të dhënat që mund të zbulojnë burimin, nëpërmjet grumbullimit, formësimit redaktues ose përhapjes së informatave.

(3) Gazetari para se ta publikojë informatën për të cilën nuk e zbulon burimin është i detyruar për këtë ta njoftojë redaktorin përgjegjës në mënyrë të përcaktuar me aktin nga neni 10 paragrafi (1) i këtij ligji.

### Ndryshimi i përmbajtjes në procedurën e përpunimit redaktues

#### Neni 13

(1) Përmbajtja kuptimi i të cilës është i ndryshuar në masë të konsiderueshme në procedurën e përpunimit redaktues nuk guxon të publikohet me emrin e autorit pa pëlqimin e tij.

(2) Për përmbajtjen e publikuar në kundërshtim me paragrafin (1) të këtij neni përgjigjet redaktori përgjegjës.

(3) Nëse me përmbajtjen e publikuar në kundërshtim me paragrafin (1) të këtij neni autori konsideron se i është cenuar dinjiteti, i njëjti ka të drejtën e kompensimit të dëmit në pajtim me ligjin.

**Impresum**

## Neni 14

(1) Emetuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm për çdo bartës individual të përmbajtjes (për shembull ekzemplar të medias së shtypur, ueb faqe, emision televiziv) të sigurojë publikimin e të dhënave si vijojnë:

- emrin dhe adresën e selisë dhe redaksisë së emetuesit të medias,

- emrin e personit përgjegjës të emetuesit të medias,

- emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës, përkatësisht redaktorëve, në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe

- emrin dhe adresën e shtypshkronjës dhe datën e shtypjes ose ri-shtypjes, si dhe numrin e ekzemplarëve të shtypur, kur bëhet fjalë për media shtypi.

(2) Për radiodifuzerët obligimi nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohet në mënyrë që të dhënat publikohen në fillim ose në fund të programeve audio/audi vizuale.

(3) Emetuesit e publikimeve elektronike obligimin nga paragrafi (1) të këtij neni e zbatojnë në mënyrë përkatëse për publikimin elektronik.

(4) Emetuesi i medias është i detyruar në vendin përkatës për çdo përmbajtje t'i publikojë të dhënat në vijim:

- emrin dhe mbiemrin e autorit të kronikës së publikuar,

- emrin dhe mbiemrin e personit, përkatësisht firmës bartës të drejtave autoriale për përmbajtjet e publikuara, përveç në media të shtypur dhe programe të radios,

- datën e produksionit (muaji dhe viti) kur bëhet fjalë për vepra audio/audi vizuale,

- origjinën e veprës audio/audi vizuale, e nëse vepra është krijuar nga produksioni i pavarur edhe informata për të,

- emrin dhe mbiemrin e personit juridik që e ruan të mirën e shfrytëzuar kulturore ose veprën arkivore, përkatësisht reproduksionin përkatës dhe

- emrin e emetuesit të medias prej të cilit është marrë kronika programore ose një pjesë e kronikës programore, përveç nëse me marrëveshje të ndërsjellë nuk është rregulluar ndryshe.

**Transparenca në punën e emetuesve të mediave**

## Neni 15

(1) Radiodifuzerët janë të detyruar që deri më 31 mars në vitin rrjedhës në formular të veçantë të përcaktuar nga trupi kompetent rregullator t'i dorëzojnë të dhëna për:

- strukturën pronësore, përkatësisht të dhëna për emrin dhe selinë e personave juridikë ose emrin dhe vendin e qëndrimit të personave fizikë që janë pronarë të aksioneve ose pjesës tek emetuesi i medias, me të dhëna për përqindjen e aksioneve ose pjesës që e kanë fituar dhe datën e fitimit,

- të dhëna për redaktorin/redaktorët përgjegjës,

- të dhëna për burimet e financimit të radiodifuzerit në vitin paraprak (reklama, sponzorime, shitje të përmbajtjeve, shërbime të siguruara ndaj palëve të treta dhe ngjashëm),

- të dhëna për të hyrat dhe shpenzimet totale të realizuara të radiodifuzerit në vitin paraprak, nga sigurimi i veprimtarisë dhe

- të dhëna për shikueshmërinë ose dëgjueshmërinë mesatare të radiodifuzerit në vitin paraprak.

(2) Emetuesit e medias së shtypur dhe emetuesit e publikimeve elektronike janë të detyruar që të dhënat nga paragrafi (1) alineja 1 të këtij neni t'i publikojnë në së paku një gazetë ditore, një herë në vit, më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhës dhe ekstraktin nga publikimi t'ia dorëzojnë trupit kompetent rregullator në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit.

(3) Radiodifuzerët janë të detyruar të dhënat nga paragrafi (1) alinetë 1, 2 dhe 3 të këtij neni t'i publikojnë edhe në programin e vet, së paku tri herë në vit, në termine kryesore dhe incizimin nga publikimi t'ia dorëzojnë trupit kompetent rregullator në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në mënyrë të përcaktuar nga trupi kompetent rregullator.

(4) Formularët nga paragrafi (1) i këtij neni publikohen në ueb faqen e trupit kompetent rregullator.

(5) Radiodifuzerët janë të detyruar që trupit kompetent rregullator t'i dorëzojnë raport me shkrim për zbatimin e obligimeve të përcaktuara në lejen për emetim të radios ose televiziv, ndërsa në veçanti për zbatimin e konceptit programor, më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhës. Në shtojcë të raportit dorëzohet edhe informata për mjetet teknike përmes të cilave emetohet ose riemtohet servisi i tyre programor në Republikën e Maqedonisë ose jashtë saj. Raporti me shkrim dorëzohet në formular që e përcakton trupi kompetent rregullator.

(6) Trupi kompetent rregullator me shkrim do ta paralajmërojë emetuesin e medias që nuk do t'i kryejë obligimet e parapara me këtë nen dhe do t'i japë afat plotësues i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 45 ditë, e në të cilin emetuesi do të detyrohet t'i kryejë obligimet nga ky nen. Nëse emetuesi i medias edhe në afatin plotësues nuk i kryen obligimet e parapara me këtë nen, trupi kompetent rregullator do ta heq lejen për emetim televiziv ose të radios në pajtim me Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audi vizuale.

(7) Emetuesi i medias të shtypur është i detyruar Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Republikës së Maqedonisë, falas t'i dorëzojë ekzemplar nga çdo numër i botuar i medias së shtypur.

(8) Dispozitat nga ky nen nuk kanë të bëjnë me servisin radiodifuziv publik.

**Mbrojtja e konkurrencës tek emetuesit e mediave**

## Neni 16

Për emetuesin e mediave në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat për mbrojtjen e konkurrencës që vlejné në Republikën e Maqedonisë.

**E drejta e korigjimit të informatës së publikuar**

## Neni 17

(1) Secili ka të drejtë që nga emetuesi i medias, përkatësisht nga redaktori përgjegjës i emetuesit të medias, të kërkojë, pa kompensim, të publikojë korigjimit të informatës së publikuar, në të cilën paraqiten fakte të

pavërteta të publikuara në informatë, e me të cilat janë shkelur të drejtat ose interesat e tij. Të drejtë korrigjimi kanë edhe personat juridikë dhe trupat dhe organizatat tjera, nëse me informatën janë shkelur të drejtat ose interesat e tyre.

(2) Kërkesa për publikimin e korrigjimit parashtrohet te redaktori përgjegjës i emetuesit të medias, në formë me shkrim në afat prej 30 ditësh nga dita e publikimit të informatës për të cilën ka të bëjë korrigjimi. Kërkesa doemos duhet të arsyetohet dhe nënshkruhet nga parashtruesi i korrigjimit dhe t'i përmbajë të gjitha të dhënat e nevojshme për parashtruesin e korrigjimit, si dhe adresën e tij.

(3) Në korrigjimin e informatës së publikuar krahas korrigjimit të pohimeve të gabuara apo konstatimeve të pasakta në informatën e publikuar, mund të paraqiten fakte dhe rrethana me të cilat parashtruesi i korrigjimit i përgënjeshtron ose thelbesisht i plotëson konstatimet e informatës së publikuar.

(4) Në rast kur bëhet fjalë për kritikë shkencore apo artistike nuk jepet e drejta e korrigjimit, përveç nëse me të njëjtën kryhet vetëm korrigjim i fakteve të pasakta.

(5) Nuk mund të kërkohet korrigjim nëse emetuesi i medias deri në ditën e parashtrimt të kërkesës për korrigjim, tanimë paraprakisht vetë e ka publikuar korrigjimin e informatës së njëjtë. Nëse parashtruesi i kërkesës për korrigjim, konsideron se emetuesi i medias nuk e ka publikuar korrigjimin në mënyrë përkatëse, në këtë rast mund të kërkojë realizimin e të drejtës së vet në pajtim me nenin 23 të këtij ligji.

(6) Nëse personi për të cilin ka të bëjë informata ka vdekur, të drejtë për publikim të korrigjimit kanë fëmijët e tij, fëmijët e adoptuar, bashkëshortët, prindërit, adoptuesit, vëllezërit dhe motrat ose personat juridikë nëse informata ka të bëjë me veprimtarinë që e ka kryer personi i vdekur lidhur me atë person juridik.

(7) Parashtruesi i kërkesës për korrigjim të informatës doemos duhet qartësisht ta shënojë informatën përkatësisht të dhënë e informatës për të cilën ka të bëjë kërkesa për korrigjim dhe datën e publikimit të saj.

### **Publikimi i korrigjimit**

#### **Neni 18**

(1) Korrigjimi publikohet pa ndryshime dhe plotësime, në vend të njëjtë apo përkatës në përmbajtjen e medias dhe në mënyrë të njëjtë apo përkatëse në të cilën është publikuar informata. Korrigjimi nuk guxon të jetë joproportionalisht më i gjatë se informata, përkatësisht nga pjesa e informatës për të cilën ka të bëjë. Korrigjimi mund të publikohet në formë të ndryshuar vetëm nëse për këtë pajtohet parashtruesi i kërkesës për korrigjim. Korrigjimi doemos duhet të publikohet në mënyrë që nga vetë titulli mund të shihet se bëhet fjalë për korrigjim. Korrigjimi pa pëlqimin e parashtruesit të kërkesës të korrigjimit, nuk guxon të publikohet ndërmjet reagimeve ose letrave të lexuesve, përkatësisht shikuesve ose dëgjuesve.

(2) Në programet e radiodifuzerëve korrigjimi publikohet me lexim në të njëjtin program dhe termin në të cilin është publikuar informata për të cilën ka të bëjë korrigjimi ose në llojin e njëjtë të programit me nivel të njëjtë të shikueshmërisë apo dëgjueshmërisë.

(3) Në publikimet elektronike theksohet dhe shënohet linku nëpërmjet të cilit mund të kihet qasje te korrigjimi i publikuar.

### **Mënyra dhe kushte për publikime të korrigjimit**

#### **Neni 19**

(1) Korrigjimi doemos duhet të publikohet në afat prej dy ditësh nga dorëzimi i kërkesës në numrin e parë të ardhshëm, nëse bëhet fjalë për botime periodike ose në media tjetër nëse bëhet fjalë për botime joperiodike. Në kohën e procesit zgjedhor, korrigjimi doemos duhet të publikohet në botimin e parë vijues, përkatësisht programin e parë vijues të llojit të njëjtë menjëherë pas pranimit të korrigjimit.

(2) Në botimin e njëjtë, përkatësisht programin e llojit të njëjtë, nuk mundet bashkë me korrigjimin të publikohet edhe komenti i atij korrigjimi ose përgjigja e korrigjimit. Për komentin e korrigjimit ose përgjigjen e korrigjimit zbatohen dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me procedurën për realizimin e të drejtës së korrigjimit.

(3) Redaktori përgjegjës obligohet që ta publikojë korrigjimin, përveç kur:

- korrigjimi nuk ka të bëjë me informatën në të cilën thirret personi i interesuar,
- korrigjimi nuk përmban të dhëna lidhur me konstatimet në informatë,
- korrigjimi është në kundërshtim me interesat e personave të tretë të mbrojtur me ligj,
- kërkesa për publikim të korrigjimit nuk është nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës ose nga personi i autorizuar i trupit shtetëror apo personi juridik,
- korrigjimi është joproportionalisht më i gjatë se informata për të cilën ka të bëjë, përkatësisht pjesa e informatës për të cilën ka të bëjë, përveç nëse korrigjimi ka të bëjë me shpifje ose informatë me përmbajtje ofenduese,
- korrigjimi është shkruar në gjuhë që nuk është identike me gjuhën me të cilën është publikuar informata e kontestuar,

- në rast kur bëhet fjalë për kritikë shkencore apo artistike, përveç nëse me të kryhet korrigjim i të dhënave të pasakta, konstatimeve ofenduese dhe tendencioze,

- tanimë është kërkuar korrigjim i përmbajtjes së njëjtë të informatës ose nëse rrjedh kontesti në gjykatën kompetente për mospublikim të korrigjimit,

- emetuesi i medias tanimë vetë e ka publikuar korrigjimin e informatës së publikuar,

- kërkesa është parashtruar pas kalimit të afatit të përcaktuar në nenin 17 paragrafi (2) të këtij ligji dhe

- korrigjimi përmban ofendim ose shpifje.

(4) Redaktori përgjegjës obligohet që në rastet nga paragrafi (3) i këtij neni, me shkrim ta njoftojnë kërkuesin e korrigjimit për shkakun e mospublikimit të korrigjimit, në afatin që është përcaktuar për publikim të korrigjimit në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

### **E drejta e kopjes së publikimit**

#### **Neni 20**

(1) Emetuesi i medias obligohet që personit të interesuar, me shpenzim të tij, t'i sigurojë kopje të informatës së publikuar edhe atë më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim të personit të interesuar.

(2) Kopja nga paragrafi (1) i këtij neni i dorëzohet personit të interesuar vetëm për përdorim personal.

(3) Nuk lejohet shumëzim as shpallje publike e kopjes nga paragrafi (1) i këtij neni, pa pëlqimin e emetuesit të medias përveç në kuadër të procedurës gjyqësore.

(4) Në rast se emetuesi i medias nuk e ka ruajtur informatën e publikuar nga paragrafi (1) i këtij neni, do të konsiderohet se emetuesi i medias e ka publikuar informatën për të cilën kërkohet korrjigim.

### **Ruajta e publikimit**

#### **Neni 21**

Nëse personi i interesuar në afat prej tetë ditësh nga publikimi i informatës me shkrim do të njoftojë se do të kërkojë publikim të korrjigimit, redaktori përgjegjës i emetuesit të medias obligohet që ta ruajë publikimin e informatës për të cilën ka të bëjë kërkesa për korrjigim, derisa korrjigimi i kërkuar nuk publikohet, përkatësisht nuk mbaron procedura gjyqësore që mbahet lidhur me informatat e kontestueshme të publikuara, përkatësisht derisa nuk mbarojnë afatet e përcaktuara me ligj për realizimin e të drejtave të korrjigimit apo mbrojtjes gjyqësore.

### **Kërkesa për korrjigim nga emetuesi i medias që ka pushuar së ekzistuari**

#### **Neni 22**

Publikim i korrjigimit mund të kërkohet edhe kur informata është publikuar nga emetuesi i medias që ndërkohë ka pushuar së ekzistuari. Parashtruesi i kërkesës për korrjigim ka të drejtë që nga emetuesi i asaj medie ose nga trashëguesi i tij juridik me shpenzime të tij, t'i sigurojë publikim të korrjigimit në medium tjetër që sipas nivelit të shikueshmërisë/dëgjueshmërisë, përkatësisht tirazhit është i ngjashëm me të.

### **E drejta për padi**

#### **Neni 23**

(1) Nëse redaktori përgjegjës i emetuesit të medias nuk e publikon korrjigimin në mënyrë dhe në afate të përcaktuara me nenin 19 të këtij ligji, personi i interesuar ka të drejtë të ngrejë padi kundër redaktorit përgjegjës para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga kalimi i afatit për publikimin e korrjigimit, përkatësisht nga dita kur korrjigimi nuk është publikuar ose është publikuar në mënyrë që nuk është në pajtim me këtë ligj.

(2) Kontestet gjyqësore lidhur me publikimin e korrjigimit zgjidhen me procedurë urgjente.

(3) Redaktori përgjegjës obligohet që gjatë publikimit të korrjigimit pas mbarimit të procedurës gjyqësore të theksojë se publikimi kryhet në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm gjyqësor e me këtë rast obligohet që ta citojë aktgjykimin e kumtuar.

### **Ndërrimi i redaktorit përgjegjës pas parashtrimit të padisë**

#### **Neni 24**

Nëse pas parashtrimit të padisë për publikim të korrjigimit ndërrohet redaktori përgjegjës i emetuesit të medias, paditësi mundet deri në fund të seancës kryesore ta ndryshojë kërkesën e padisë dhe në vend të të paditurit paraprak ta paditë redaktorin e ri përgjegjës. Për këtë ndryshim të kërkesës së padisë nuk nevojitet pëlqim nga i padituri paraprak, as nga redaktori i ri përgjegjës.

### **E drejta për publikim të informatave të lidhura me procedura gjyqësore**

#### **Neni 25**

(1) Secili person juridik apo fizik i përmendur në përmbajtje të medias se kundër tij është parashtruar kallëzim penal ose është ngritur procedurë hetimore apo penale ka të drejtë që në afat prej tre muajsh nga marrja e vendimit për hedhje poshtë të kallëzimit penal, miratimit të aktvendimit të plotfuqishëm me të cilin ndërpritet procedura hetimore apo penale ose është miratuar aktgjykim lirues i plotfuqishëm, të kërkojë nga redaktori përgjegjës që ta publikojë informatën për këtë.

(2) Në publikimin e informatës nga paragrafi (1) i këtij neni, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me procedurën për realizimin e kërkesës për korrjigim.

### **E drejta për përgjigje të informatës së publikuar**

#### **Neni 26**

(1) Personi fizik ose juridik ka të drejtë të paraqesë kërkesë te emetuesi i medias përkatësisht te redaktori përgjegjës i emetuesit të medias, që pa kompensim ta publikojë përgjigjen e tij të informatës së publikuar, nëse personi fizik ose juridik ka lidhje me faktet e paraqitura të publikuara në informatë ose nëse ka interes legjitim.

(2) Përgjigjja nga paragrafi (1) i këtij neni, përmban tekst apo porosi të natyrës së njëjtë dhe me gjatësi të njëjtë si informata e publikuar. Me përgjigje thelbësisht mohohen ose thelbësisht plotësohen të dhënat e kontestueshme për faktet dhe të dhënat në informatën e publikuar.

### **Mënyra e publikimit të përgjigjes**

#### **Neni 27**

(1) Përgjigjja e informatës së publikuar doemos duhet të publikohet pa ndryshim ose plotësim me përjashtim të gabimeve drejtshkrimore.

(2) Redaktori përgjegjës ka të drejtë që nga parashtruesi i kërkesës për publikim të përgjigjes së informatës së publikuar, para publikimit të kërkojë shkurtim të përgjigjes.

(3) Në të drejtën e përgjigjes zbatohen dispozitat e nenit 19 të këtij ligji.

(4) Redaktori përgjegjës mund të refuzojë ta publikojë përgjigjen në rastin kur informata e publikuar është pjesë e informatës së besueshme nga seanca publike të organeve shtetërore dhe gjykatave.

(5) Redaktori përgjegjës mund të refuzojë ta publikojë përgjigjen edhe në rastin kur në përgjigje theksohen të dhëna ose konstatime dukshëm të pasakta, si dhe të dhëna tjera të cilat me siguri janë të papërshtatshme për dëshmim.

(6) Nëse redaktori përgjegjës konsideron se vetëm disa nga të dhënat ose konstatimet janë të pasakta apo të papërshtatshme për dëshmim, ai nuk guxon të refuzojë ta publikojë përgjigjen pa e ftuar paraprakisht parashtruesin e kërkesës për përgjigje që t'i përjashtojë nga përgjigjja ato të dhëna dhe pohime.

### E drejta për padi

#### Neni 28

Dispozitat e nenit 23 të këtij ligji që kanë të bëjnë me të drejtën e padisë, në mënyrë përkatëse zbatohen edhe në rastin kur redaktori përgjegjës i emetuesit të medias nuk e publikon përgjigjen e informatës së publikuar.

### Mbikëqyrja

#### Neni 29

(1) Trupi kompetent rregullator kryen ekskluzivisht mbikëqyrje administrative të plotësimin të obligimeve të përcaktuara në nenet 6, 7, 8, 10, 14 dhe 15 të këtij ligji, sipas Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

(2) Masat që trupi kompetent rregullator mund t'i marrë, e të cilat janë të përcaktuara në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në mënyrë përkatëse zbatohen edhe në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji.

### Dispozita ndëshkuese

#### Neni 30

(1) Gjobë në shumë prej 4 000 deri në 5 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

1) media e shtypur me përmbajtje pornografike nuk siguron mbrojtjen e personave të mitur në mënyrë të përcaktuar në nenin 6 paragrafi (1) të këtij ligji;

2) emetuesi i publikimit elektronik nuk siguron mbrojtjen e personave të mitur në mënyrë të përcaktuar në nenin 6 paragrafi (2) të këtij ligji;

3) nuk emëron redaktor përgjegjës (neni 8 paragrafi (1));

4) nuk i publikon të dhënat në pajtim me nenin 14 të këtij ligji;

5) nuk i dorëzon të dhënat në afat dhe mënyrë të përcaktuar në nenin 15 paragrafi (1) ose nuk i publikon të njëjtat në pajtim me nenin 15 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji dhe

6) nuk dorëzon raport me shkrim në mënyrë dhe në afat në pajtim me nenin 15 paragrafi (5) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 500 deri në 2 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik dhe tregtarit individ për kundërvajtjen e kryer nga paragrafi (1) i këtij neni.

#### Neni 31

(1) Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 3 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

1) nuk publikon kumtime ose deklarata zyrtare nga organe dhe trupa kompetentë shtetërorë në pajtim me neni 7 paragrafi (1) të këtij ligji;

2) nuk e miraton aktin e përgjithshëm ose nuk e bën publikisht të arritshëm (neni 10 paragrafët (1) dhe (2));

3) nuk dorëzon ekzemplar nga çdo numër i botuar në shtyp në Bibliotekën Nacionale dhe Universitare të Republikës së Maqedonisë (neni 15 paragrafi (7));

4) nuk kryen publikim të korrigjimit në pajtim me nenin 18 të këtij ligji;

5) nuk e kryen publikimin e korrigjimit në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me nenin 19 të këtij ligji;

6) personit të interesuar nuk i siguron kopje të informatës së publikuar, në pajtim me nenin 20 paragrafi (1) të këtij ligji;

7) nuk e publikon informatën e kërkuar në pajtim me nenin 25 të këtij ligji dhe

8) nuk e publikon përgjigjen në mënyrë në pajtim me nenin 27 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 500 deri në 1 000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik dhe tregtarit individ për kundërvajtjen e kryer nga paragrafi (1) i këtij neni.

### Dispozita kalimtare

#### Neni 32

Emetuesit ekzistues të mediave të cilët janë persona juridikë, aktin e përgjithshëm nga neni 10 paragrafi (1) të këtij ligji duhet ta miratojnë në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 33

Të dhënat nga neni 5 paragrafi (5) të këtij ligji, për emetuesit ekzistues të medias së shtypur dhe për emetuesit ekzistues të publikimeve elektronike, Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë është i detyruar t'i dorëzojë të trupi kompetent rregullator në afat prej dy muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 34

Formularin nga neni 15 paragrafi (1) të këtij ligji, trupi kompetent rregullator do ta miratojë në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### Dispozita të fundit

#### Neni 35

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".